



Komunikatë

12.07.2013

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti mbledhjen e 33-të kë kryesuar nga znj. Valdete Daka, e cila fillimisht tha se, do të paraqesë raport lidhur me vizitën në Bruksel. Ndërkaq, mbledhja filloi me paraqitjet e aktiviteteve të të SKQZ-së. Kryeshefi, Enis Halimi, tha se, po shqyrtohen dhe po analizohen nominimet e KKZ-ve, dhe është duke u prodhuar Lista votuese. Po ashtu, janë draftuar specifikat e Listës Komunale Votuese dhe Listës Qendrore. Kemi bërë edhe një kërkesë në Këshillin Gjyqësor për personat që u është marrë aftësia e veprimit personave, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Janë hartuar Draf memorandumet për votimet e personave me nevoja të veçanta që, do të nënshkruhet me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

KQZ, ka shqyrtuar gjerësisht përgatitjet për emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2013. Në debat, kanë marrë pjesë: Alban Krasniqi, Enis Halimi, Haki Krasniqi, Florian Dushi, Ilir Gashi, Valdete Daka, Binak Vishaj dhe Bajram Ljatifi.

Pas kësaj pike, KQZ ka shqyrtuar dhe miratuar Strategjinë e Informimit Publik për zgjedhjet e 3 nëntorit 2013. Raportin e detajuar lidhur me Informimin Publik, e ka paraqitur, Adnan Rustemi, zyrtar i Departamentit të Shërbimit Votues. Strategjia, si qëllim ka informimin e votuesve për të gjitha fazat, rolin e votuesve, të drejtat, dhe synon të rrisë pjesëmarrjen në zgjedhje, të inkurajojë kategoritë e ndryshme për të dalë në zgjedhje, grupet gjinore etj. KQZ, miratoi Strategjinë për Informim Publik, dhe kërkoi që për Informim Publik të përcaktohen kriteret dhe përmes tyre, ta siguroj operatorin ekonomik i cili, ofron kushte dhe kualitet.

KQZ, në këtë mbledhje kërkoi nga SKQZ që të shqyrtohet mundësia e sigurimit të Qendrës Mediale për zgjedhjet sa më afër selisë së KQZ-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
